



Zonat Funktionale

Partneriteti Publiko-Privat

Albana Dhimitri
Gjergj Buxhuku

**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdo Toptani
Torre Drin, Kati i 3-të
Kutia postare 1418
Tiranë, Albania

Autorët: **Albana Dhimitri**

Gjergj Buxhuku

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Tabela e përmbajtjes

I.	Njësitë E Reja Lokale Dhe Partneriteti Privat.....	3
II.	Zona funksionale Durrës.....	4
III.	Zona funksionale Elbasan.....	9
IV.	Zona funksionale Korçë.....	13
V.	Zona funksionale Fier.....	18
VI.	Zona funksionale Vlorë.....	23
VII.	Zona funksionale Përmet.....	29
VIII.	Përfitimet e Partneritetit Publiko-Privat/Disa nga arsyet për adoptimin e qasjes se PPP.....	34

Njësitë E Reja Lokale Dhe Partneriteti Privat

Zbatimi i Reformës Territoriale dhe Administrative do përballet me shumë sfida në lidhje me qeverisjen vendore. Me ndarjen e re në 61 bashki, aranzhimet e rëndësishme administrative dhe ndryshimet thelbësore organizative duhet të merren parasysh në shpërndarjen dhe ofrimin e shërbimeve publike, për shkak të njërive më të mëdha që janë krijuar; duke pasur parasysh se ndarja e re do të ndikojë në kërkesën për shërbimet lokale, dhe aftësinë e autoriteteve për t'i ofruar. Për pothuajse të gjitha njësitë, ndarja e re në 61 bashki të çon në ridizajnimin e shërbimeve publike, duke marrë parasysh partneritetet publiko-privat si një mënyrë e shkëlqyer për të rritur ofrimin e shërbimeve, si dhe të inkurajojë ndërmarrjet lokale.

Në këtë studim ne do të merremi me 6 zona funksionale: Durrës, Elbasan, Korçë, Fier, Vlorë, Përmet, duke marrë në konsideratë fushat e mundshme që Partneriteti Publiko-Privat mund të implementohet.

Me zgjerimin e hapësirës gjeografike të këtyre zonave funksionale, autoritetet lokale duhet të konsiderojnë ndarjen e shërbimeve më shumë se kurrë më parë, të angazhohen me partnerët privatë në mënyra të reja dhe inovative dhe ndërtimin e partneriteteve private publike që ofrojnë shërbime më të integruara.

Përmes formatit të ri të PPP, qëllimi nuk është vetëm për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e këtyre shërbimeve, por edhe prodhimin e shërbimeve cilësore për qytetarët dhe fondeve publike në favor të buxhetit të shtetit.

Një shumëllojshmëri e sektorëve, për herë të parë, të tilla si bujqësia, shëndetësia apo regjistrimi i pasurive të paluajtshme, siguria e ushqimit, shërbimi spitalor në traditë kanë qenë natyrisht në kurriz të buxhetit të shtetit, do të fillojë të shihet ndryshe duke sjellë së bashku përmes kontraktimeve publiko-privat një favorizim të qytetarëve me shërbime cilësore.

Zona funksionale Durrës

Durrësi është renditur si qyteti i dytë për zhvillim ekonomik mbas Tiranës, ku sektorët më të rëndësishëm janë turizmi dhe ndërtimi. Migrimi i lartë ka cuar në zgjerim të shpejtë dhe informal të zonave të ish kënetës dhe vijës bregdetare duke krijuar vështirësi në ofrimin e shërbimeve publike.

Durrësi është një nga zonat më problematike për furnizimin me ujë për shkak se burimet ujore janë të kufizuara dhe në distancë të largët.

Zona funksionale Durrës përbëhet nga pesë njësi vendore: Bashkia e Durrësit, bashkia e Sukthit dhe komunat Rrashbull, Katund i Ri, Ishmi. Katër prej tyre shtrihen në bregdet ose menaxhojnë një pjesë të bregdetit duke ndarë interesat e përbashkëta në infrastrukturë, zhvillim urban, mjedisor dhe industrial, të orientuar kryesisht drejt turizmit, tregtisë, sektori i veshjeve dhe industrisë së përpunimit. Kjo është një pikë kyçe për zhvillimin dhe avancimin e turizmit bregdetar në këtë rajon. Në këtë seksion partneriteti publik-privat mund të aplikohet në shumë shërbime.

- *Menaxhimi i unifikuar i bregdetit (PPP për menaxhimin e të gjithë vijës bregdetare prej 62 km)*
- *Menaxhimi i plazheve publike*
- *Mirëmbajtja e plazheve*
- *Mbrojtja*

Për sa i përket sektorëve të tjerë në të cilët PPP mund të vijë në ndihmë janë:

- *Infrastruktura rrugore*

Zona ka një infrastrukturë të zhvilluar në sajë të pozicionit të saj strategjik në zonën qendrore të detit Adriatik dhe shërben si një qendër e madhe për udhëtarët dhe mallrat për të gjithë vendin, edhe për banorët vendas. Për këtë arsye PPP mund të vijë në ndihmë për mirëmbajtjen e rrugëve.

- *PPP në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës si mjet për rritjen e cilësisë së shërbimit.*

- *PPP ne përmirësimin e infrastrukturës, për transportin e mallrave.*
- *PPP në përmirësimin e cilesisë së rendit publik dhe sigurisë civile, kontrollit të trafikut, sigurisë në plazhe.*
- *Shërbimi publik (urbanët)*

Përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike duhet të jetë pjesë e një investimi të integruar të sektorit publik dhe të kuadrit të prokurimit.

- *Ndriçimi i rrugëve dhe parkimi publik në qytet me ndihmën e partneritetit publik-privat.*
- *Ujësjellësi dhe kanalizimet*

Një tjetër rast i përfshirjes së PPP-ve i përket kontratës së menaxhimit me “Katër Bashkitë” Durrës, Fier, Lezhë, Sarandë, e cila u zbatua me mbështetjen financiare të Bankës Botërore. Kjo kontratë përfundoi në fund të gusht 2008 dhe mund të quhet si relativisht e suksesshme bazuar në treguesit e performances, të cilët u përmirësuan ndjeshëm.

Vështirësitë e përfshirjes së PPP-ve në këtë sektor kanë të bëjnë me faktin se kompanitë e ujësjellës kanalizimeve janë të vogla dhe fitimi i investitorëve është ulët për shkak të mos arritjes së ekonomive të shkallës.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Qeveria Shqiptare sheh me përparësi tërheqjen e investitorëve të huaj në sektorin e ujit dhe për këtë qëllim parashikon bashkimin e kompanive të ujësjellesit dhe krijimin e disa rajoneve si një mënyrë për të thithur fondet e investitorëve. Argumenti kryesor për rajonizimin është arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja më pas e investitorëve të huaj në formën e partneritetit publik-privat.

- *Mbledhja dhe trajtimi i ujërave të zeza në Durrës*

Mbledhja dhe trajtimi i ujërave të zeza në Durrës është një nga investimet më të mëdha të viteve të fundit, i cili ka një rëndësi strategjike për cilësinë e turizmit detar në zonë dhe në të gjithë vendin. Në kushtet aktuale nga pamundësia për të mbuluar shpenzimet operative, ky investim mbetet i brishtë. Administrimi nga PPP do të çojë në rritjen e mundësive ekonomike për vazhdimin e punës në këtë fabrikë të rëndësishme.

- *Riciklimi i mbetjeve*

PPP në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane, largimit dhe asgjësimit të mbetjeve, mirëmbajtjen e higjenës publike në qytet, mirëmbajtjen e fushëgrumbullimeve dhe ripozicionimin e fushëgrumbullimeve të pa aprovuara në territorin e bashkisë, fushate për edukimin dhe ndergjegjesimin e qytetarëve.

- *Një pikë me rëndësi është mundësia e mbledhjes dhe riciklimit të mbetjeve dhe krijuar Landfield në zonat më pak të populluara.*

Kepi i Rodonit, një nga atraksionet turistike që ofron Durrësi është i ndotur me mbetje plastike të sjella nga lumenjtë.

- *PPP në rehabilitimin e zonave të gjelbëra.*

Durrësi është një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytet gjenden disa shtresa qyteterimesh antike. Ndërtimi pa kriter ka demtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

- *PPP për ruajtjen dhe rehabilitimin e zonave arkeologjike.*
- *PPP për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve, në zonën e ish kënetës dhe vijës bregdetare.*
- *PPP në ndërtimin, përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e Zonës ekonomike me statusin e “Parkut Industrial” në Spitallë, Durrës, miratuar me VKM nr.391, datë 21.02.2008 Ka sipërfaqe 850 hektarë, pronësi shtetërore dhe private, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517 në Spitallë, Durrës dhe do të jete në funksion të veprimtarisë portuale dhe prodhuese që do të kryhet në zonë.*
- *PPP në vaditje dhe sistemin e kullimit*

Vaditja dhe kullimi janë aplikimi artificial i ujit në tokë dhe heqja artificiale e ujit të tepërt nga toka, respektivisht. Disa toka kërkojnë vaditje apo kullim para se të jenë të gatshme për përdorim për ndonjë prodhim bujqësor; fitime të tjera të tokës nga të dyja praktikat për të rritur prodhimin. Përmirësimet e ujitjes dhe të kullimit nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive.

Shpesh të dyja mund të kërkohen së bashku për të siguruar qëndrueshërinë, prodhimin bujqësor të nivelit të lartë.

Vaditja është shfrytëzuar gjerësisht, vaditësit lokalë në përgjithësi kanë një nivel minimal të kuptuarit se si të veprojnë dhe të ruajnë sistemin. Përveç kësaj, sistemet sipërfaqësore janë shpesh më të pranueshme për bujqërit të cilët i vlerësojnë efektet e mungesës së ujit në bujqësi duke thënë se është me i lehtë aplikimi i sistemit sipërfaqësor.

- *PPP në Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit, nëpërmjet analizimit të bregdetit.*
- *PPP në organizimin dhe funksionimin e Tregjeve Bujqësore dhe Industriale.*
- *Ndërtimi i shkollave me infrastrukturë dhe objekte të të njëjtave standarte.*

Infrastruktura e nevojshme do të ofrohet në shkolla të tilla jo vetëm për të përmbushur nevojat e mësimdhënies, por edhe për aktivitete sportive dhe bashkë-kurrikulare. Do të ketë objekte të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Objektet si shesh lojërash, kopshte, auditor, etj do të ofrohen në këto shkolla. Dhe gjithashtu do të ndërtohet një bibliotekë e mirë me libra dhe revista për nxënësit dhe mësuesit.

Këto shkolla do të kenë infrastrukturë të përshtatshme, qasje në Internet dhe mësimi i kompjuterit me orar të plotë.

Shkollat do të kenë lehtësira për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe duhet të ketë mësues të veçantë. Ngrohja do të jetë e aktivizuar në këto institucione arsimore me energji të ripërtëritshme.

- *Në kushtet ekonomike që jemi, një mundësi, në mos e vetmja, për përmirësimin e gjendjes në spitalet publike është Partneriteti Publik-Privat.*

Ky partneritet nuk është i ri. Në vendet e zhvilluara, dekadat e fundit aplikohet me sukses edhe në sistemin shëndetësor. Është një mënyrë për rritjen e ndikimit të mekanizmave të tregut, duke ruajtur kontrollin publik. Nëpërmjet tij sigurohet si *rol i rregullues* i shtetit (solidariteti social) ashtu edhe përfitimet e mekanizmave të tregut, hapja e sistemit shëndetësor publik ndaj konkurrencës, etj.

Të dy partnerët (publik dhe privat) zhvillojnë produktet dhe ndajnë riskun, koston dhe të ardhurat.

Në spitale publike, *partneriteti publiko-privat* mund të aplikohet pak a shumë, në të gjitha shërbimet që më parë i ofronte shteti, i cili mund të kontraktojë sektorin privat për të siguruar *shërbime*: pastrim, hoteleri, kuzhinë; *mallra*: medikamente, reagentë kimikë, ushqime, etj; *menaxhim*: të spitalit apo të faciliteteve. PPP do të merret me menaxhimin e përgjithshëm të spitalit.

- *PPP për strehimin social*

Ofrimi i strehimit dhe shërbimeve përkatëse për komunitetin në nevojë.

- *Zgjerimi i industrisë së veshjeve* që luan një rol të rëndësishëm në këtë fushë, sepse Durrësi ka një pozitë të mirë strategjike duke pasur afër portin që mundëson eksportin e mallrave në vendet e zhvilluara. Kjo shkakton një rritje në punësim.

Zona funksionale Elbasan

Zona funksionale Elbasan shtrihet dhe përfshin 13 njësi ekzistuese të qeverisjes vendore; Elbasan; Labinot Fushë; Labinot Mal; Funar; Gracen; Bradashesh; Shushicë; Papër; Shirgjan; Tregan; Gjergjan; Gjinar; Zavalinë.

Kjo është zona funksionale më e madhe e propozuar në qarkun Elbasan për sa i përket numrit dhe dendësisë së popullsisë. Në këtë zonë ka një përqëndrim të institucioneve dhe aktivitetit ekonomik në zonat urbane. Zonat rurale të këtij rajoni janë furnizuesit në bujqësi dhe fuqi punëtore. Ndërsa në anën tjetër infrastruktura, shërbimet dhe punësimi është i vendosur në zonat urbane.

Kryeministri Rama propozoi zhbllokimin e procesit të përpunimit të plehrave duke moslejuar në këtë mënyrë ngritjen e mëtejshme të kodrave me plehra, që digjen pranë apo në mes të qytetit. Sistemimi i land fieldit-it të Elbasanit është absolutisht i përballueshëm nga partneriteti publik-privat apo bashkia e qytetit.

- *PPP për grumbullimin, asgjësimin dhe menaxhimin e Land field-it.*
- *PPP në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane, largimit dhe asgjësimit të mbetjeve, mirëmbajtjen e higjenës publike në qytet, mirëmbajtjen e fushëgrumbullimeve dhe ripozicionimin e fushëgrumbullimeve të pa aprovuara në territorin e bashkisë, fushatë për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.*

Trajtimi i fushës aktuale është shumë i rëndësishëm duke qënë se ndikon në ndotjen e lumit Shkumbin.

Në bashkinë e Elbasanit është lokalizuar një pjesë e madhe e industrisë së rëndë si ferrokrom, cemento, celiku etj. Kjo i ka sjellur zonës një nga nivelet më të larta të ndotjes së ajrit dhe të ujit në vend.

- Domosdoshmëri PPP në Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit, nëpërmjet analizimit të burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës.
- Llogaritja e nivelit të ndotjes në rajonin e ish metalurgjisë.

- Monitorimi i nivelit të ndotjes akustike, për të gjykuar mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave.
- *Infrastruktura rrugore*

Rrugët e brendshme të qytetit janë pjesërisht të amortizuara . Rrugët lidhëse me shumë fshatra janë në gjendje të keqe. Krijimi i një shërbimi për transportin publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës komunitare brenda njësisë së re administrative, si dhe marrjen e shërbimeve më lehtë të aksesueshme.

- *PPP në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës si mjet për rritjen e cilësisë së shërbimit.*
- *PPP në përmirësimin e cilësisë së rendit publik dhe sigurisë civile, kontrollit të trafikut.*
- *Shërbimi publik (urbanët)*

Përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike duhet të jetë pjesë e një investimi të integruar të sektorit publik dhe të kuadrit të prokurimit.

Krijimi i një shërbimi të transportit publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës së komunitetit brenda njësisë së re administrative, si dhe duke bërë shërbime më lehtë të arritshme.

- *Ndriçimi i rrugëve dhe parkimi publik në qytet me ndihmën e partneritetit publik-privat.*
- *Ujësjellësi dhe kanalizimet*

Konkretisht shembulli i parë i PPP i përket konçensionit të Elbasanit që ju dha Berlinwasser International në vitin 2002 për ish Ndërmarrjen Shtetërore të Ujësjellës Kanalizimeve që i shërbente qytetit të Elbasanit. Ndonëse ky konçesion u dha për 30 vjet zgjati vetëm 5 vjet për shkak të dështimeve financiare me të cilat u përball konçensionari.

Vështirësitë e përfshirjes së PPP-ve në këtë sektor kanë të bëjnë me faktin se kompanitë e ujësjellës kanalizimeve janë të vogla dhe fitimi i investitorëve është ulët për shkak të mos arritjes së ekonomive të shkallës.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Qeveria Shqiptare sheh me përparësi tërheqjen e investitorëve të huaj

në sektorin e ujit dhe për këtë qëllim parashikon bashkimin e kompanive të ujësjellesit dhe krijimin e disa rajoneve si një mënyrë për të thithur fondet e investitorëve. Argumenti kryesor për rajonizimin është arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja më pas e investitorëve të huaj në formën e partneritetit publik-privat.

- *PPP në vaditje dhe sistemin e kullimit*

Vaditja dhe kullimi janë aplikimi artificial i ujit në tokë dhe heqja artificiale e ujit të tepërt nga toka, respektivisht. Disa toka kërkojnë vaditje apo kullim para se të jenë të gatshme për përdorim për ndonjë prodhim bujqësor; fitime të tjera të tokës nga të dyja praktikat për të rritur prodhimin. Përmirësimet e vaditjes dhe të kullimit nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive. Shpesh të dyja mund të kërkohen së bashku për të siguruar qëndrueshërinë, prodhimin bujqësor të nivelit të lartë .

Vaditja është shfrytëzuar gjerësisht, vaditësit lokalë në përgjithësi kanë një nivel minimal të kuptuarit se si të veprojnë dhe të ruajnë sistemin. Përveç kësaj, sistemet sipërfaqësore janë shpesh më të pranueshme për bujqërit të cilët i vlerësojnë efektet e mungesës së ujit në bujqësi duke thënë se është me i lehtë aplikimi i sistemit sipërfaqësor.

- *PPP në organizimin dhe funksionimin e Tregjeve Bujqësore dhe Industriale.*
- *Ndërtimi i shkollave me infrastrukturë dhe objekte të të njëjtave standarte.*

Infrastruktura e nevojshme do të ofrohet në shkolla të tilla jo vetëm për të përmbushur nevojat e mësimdhënies, por edhe për aktivitete sportive dhe bashkë-kurrikulare. Do të ketë objekte të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Objektet si shesh lojërash, kopshte, auditor, etj do të ofrohen në këto shkolla. Dhe gjithashtu do të ndërtohet një bibliotekë e mirë me libra dhe revista për nxënësit dhe mësuesit.

Këto shkolla do të kenë infrastrukturë të përshtatshme, qasje në Internet dhe mësimi i kompjuterit me orar të plotë.

Shkollat do të kenë lehtësira për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe duhet të ketë mësues të veçantë. Ngrohja do të jetë e aktivizuar në këto institucione arsimore me energji të ripërtëritshme.

- *Në kushtet ekonomike që jemi, një mundësi, në mos e vetmja, për përmirësimin e gjendjes në spitalet publike është Partneriteti Publik-Privat.*

Ky partneritet nuk është i ri. Në vendet e zhvilluara, dekadat e fundit aplikohet me sukses edhe në sistemin shëndetësor. Është një mënyrë për rritjen e ndikimit të mekanizmave të tregut, duke ruajtur kontrollin publik. Nëpërmjet tij sigurohet si *rol i rregullues* i shtetit (solidariteti social) ashtu edhe përfitimet e mekanizmave të tregut, hapja e *sistemit shëndetësor publik* ndaj konkurrencës, etj.

Të dy partnerët (publik dhe privat) zhvillojnë produktet dhe ndajnë riskun, koston dhe të ardhurat.

Në spitale publike, *partneriteti publik-privat* mund të aplikohet pak a shumë, në të gjitha shërbimet që më parë i ofronte shteti, i cili mund të kontraktojë sektorin privat për të siguruar *shërbime*: pastrim, hoteleri, kuzhinë; *mallra*: medikamente, reagentë kimikë, ushqime, etj; *menaxhim*: të spitalit apo të faciliteteve.

- *PPP për strehimin social*

PPP për strehimin social nëpërmjet menaxhimit të pronave vendore si dhe ofrimi i strehimit dhe shërbimeve përkatëse për komunitetin në nevojë.

- *PPP për rehabilitimin e lagjeve periferike.*
- *PPP në administrimin e lixhave dhe banjave termale*

Elbasani shquhet për lixhat dhe banjot termale. Ata ndodhen pranë qytetit të Elbasanit. Këto burime janë të njohura dhe të përdorura që gjatë periudhës romake. Analizat e ujërave të këtyre burimeve janë kryer në mënyrë të specializuar nga ana e inxhinierëve çekë, të cilët kanë evidentuar vlera të larta terapeutike. Këtu trajtohen sëmundje të shumta të rrugëve të frymëmarrjes, sistemit nervor, të lëkurës, stomakut, etj. Lixhat e Elbasanit kanë edhe vlera kozmetike.

- *Promovimi i turizmit malor, shpati i Gjinarit, përmirësimi i infrastrukturës, formimi dhe trajnimi i guidave profesionale.*
- *Rehabilitimi dhe mbrojtja e Parkut kombëtar të Shpatit, i cili ka një shkallë të lartë të dëmtimit nga prerjet e paligjshme.*
- *PPP për rehabilitimin dhe shtimin e zonave të gjelbra.*

- *PPP për rehabilitimin e parkut të Krastës dhe përmirësimin e infrastrukturës.*
- *PPP në ndërtimin, përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e Zonës ekonomike me statusin e “Parkut Industrial” në Elbasan, miratuar më 4 qershor 2008, shtrihej në një sipërfaqe prej 254.7 hektarësh në rajonin e ish-metalurgjisë.*

Zona funksionale Korçë

Zona funksionale Korçë përfshin 9 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Korçës që në aspektin administrativ përcaktohet si qytet qendër qarku me rendësi kombëtare. Zona funksionale përfshin komunat Drenovë, Mollaj, Bulgarec, Pojan, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lekas, të përcaktuara kryesisht si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë qendër e zonës funksionale.

Kjo zonë funksionale ka shumë sektorë ku PPP mund të vijë në ndihmë:

- *Infrastruktura rrugore*

Rrugët e brendshme të qytetit janë tërësisht të amortizuara dhe investimet raportohen të mangëta. Rrugët lidhëse me shumë fshatra janë në gjendje të keqe. Krijimi i një shërbimi për transportin publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës komunitare brenda njësisë së re administrative, si dhe marrjen e shërbimeve më lehtë të aksesueshme.

- *PPP në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës si mjet për rritjen e cilësisë së shërbimit.*
- *PPP në përmirësimin e cilësisë së rendit publik dhe sigurisë civile, kontrollit të trafikut.*
- *Shërbimi publik (urbanët)*

Përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike duhet të jetë pjesë e një investimi të integruar të sektorit publik dhe të kuadrit të prokurimit.

Krijimi i një shërbimi të transportit publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës së komunitetit brenda njësisë së re administrative, si dhe duke bërë shërbimet më lehtë të arritshme.

- *Ndriçimi i rrugëve dhe parkimi publik në qytet me ndihmën e partneritetit publik-privat.*
- *PPP në infrastrukturën dhe shërbimet publike.*
- Me mbështetje nga USAID, Bashkia Korçë po punon për të kryer një ‘studim fizibiliteti’ (studim vlerësimi teknik-ekonomik), që do të shqyrtojë opsionet më të mira teknike-financiare për përmirësimin e parkimit publik dhe të situatës së trafikut. Si pjesë e këtij ‘studimi’, bashkia do të zhvillojë një seri diskutimesh dhe sondazhesh me qytetarët dhe

bizneset, për të marrë opinionet e nevojshme nga palët e interesuara që mund të preken apo të ndikohen nga zbatimi i këtij projekti.

- *PPP në rritjen e cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm*
- *Krijimi i këtyre zonave funksionale mund të shoqërohet në të ardhmen edhe me ndryshime në strukturën e operatorëve dhe shtrirjen e mbulimit me shërbim të furnizimit me ujë dhe kanalizime.*

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Qeveria Shqiptare sheh me përparësi tërheqjen e investitorëve të huaj në sektorin e ujit dhe për këtë qëllim parashikon bashkimin e kompanive të ujësjellesit dhe krijimin e disa rajoneve si një mënyrë për të thithur fondet e investitorëve. Argumenti kryesor për rajonizimin është arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja më pas e investitorëve të huaj në formën e partneritetit publik-privat.

- *PPP në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane, largimit dhe asgjësimit të mbetjeve, mirëmbajtjen e higjenës publike në qytet, mirëmbajtjen e fushëgrumbullimeve dhe ripozicionimin e fushëgrumbullimeve të pa aprovuara në territorin e bashkisë, fushate për edukimin dhe ndergjegjesimin e qytetarëve.*

Korça ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta, por dhe një rritje të numrit të popullsisë së moshës së re si pasojë e migrimit nga zonat rurale.

- *Janë të domosdoshme PPP për kualifikimin dhe përgatitjen për tregun e punës.*

Spektori më i zhvilluar në zonat rurale është bujqësia dhe frutikultura. Por pjesa më e madhe e produkteve të tyre nuk arrijnë të tregtohen në treg. Kjo sepse shërbimet e infrastrukturës dhe transportit janë shumë të limituara në zonat rurale sidomos në zonat më të thella si Lekas, Vithkuq, Panarit etj, të cilat dhe për shkak të klimës së ashpër izolohen cdo vit.

- *Janë të domosdoshme PPP në përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe transportit publik ndërlidhes, i cili është joekzistent në zonat e largëta.*

- *PPP në vaditje dhe sistemin e kullimit*

Vaditja dhe kullimi janë aplikimi artificial i ujit në tokë dhe heqja artificiale e ujit të tepërt nga toka, respektivisht. Disa toka kërkojnë vaditje apo kullim para se të jenë të gatshme për përdorim për ndonjë prodhim bujqësor; fitime të tjera të tokës nga të dyja praktikat për të rritur prodhimin.

Përmirësimet e vaditjes dhe të kullimit nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive. Shpesh të dyja mund të kërkohen së bashku për të siguruar qëndrueshërinë, prodhimin bujqësor të nivelit të lartë .

Vaditja është shfrytëzuar gjerësisht, vaditësit lokalë në përgjithësi kanë një nivel minimal të kuptuarit se si të veprojnë dhe të ruajnë sistemin. Përveç kësaj, sistemet sipërfaqësore janë shpesh më të pranueshme për bujqërit të cilët i vlerësojnë efektet e mungesës së ujit në bujqësi duke thënë se është më i lehtë aplikimi i sistemit sipërfaqësor.

- *PPP në organizimin dhe funksionimin e Tregjeve Bujqësore.*
- *PPP në organizimin dhe funksionimin e Tregjeve Industriale në qytetin e Korçës.*
- *Ndërtimi i shkollave me infrastrukturë dhe objekte të të njëjtave standarte.*

Infrastruktura e nevojshme do të ofrohet në shkolla të tilla jo vetëm për të përmbushur nevojat e mësimdhënies, por edhe për aktivitete sportive dhe bashkë-kurrikulare. Do të ketë objekte të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Objektet si shesh lojërash, kopshte, auditor, etj do të ofrohen në këto shkolla. Dhe gjithashtu do të ndërtohet një bibliotekë e mirë me libra dhe revista për nxënësit dhe mësuesit.

Këto shkolla do të kenë infrastrukturë të përshtatshme, qasje në Internet dhe mësimi i kompjuterit me orar të plotë.

Shkollat do të kenë lehtësira për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe duhet të ketë mësues të veçantë. Ngrohja do të jetë e aktivizuar në këto institucione arsimore me energji të ripërtëritshme.

- *Në kushtet ekonomike që jemi, një mundësi, në mos e vetmja, për përmirësimin e gjendjes në spitalet publike është Partneriteti Publik-Privat.*

Ky partneritet nuk është i ri. Në vendet e zhvilluara, dekadat e fundit aplikohet me sukses edhe në sistemin shëndetësor. Është një mënyrë për rritjen e ndikimit të mekanizmave të tregut, duke ruajtur kontrollin publik. Nëpërmjet tij sigurohet si *rol i rregullues* i shtetit (solidariteti social) ashtu edhe përfitimet e mekanizmave të tregut, hapja e sistemit shëndetësor publik ndaj konkurrencës, etj.

Të dy partnerët (publik dhe privat) zhvillojnë produktet dhe ndajnë riskun, koston dhe të ardhurat.

Në spitale publike, *partneriteti publik-privat* mund të aplikohet pak a shumë, në të gjitha shërbimet që më parë i ofronte shteti, i cili mund të kontraktojë sektorin privat për të siguruar *shërbime*: pastrim, hoteleri, kuzhinë; *mallra*: medikamente, reagentë kimikë, ushqime, etj; *menaxhim*: të spitalit apo të faciliteteve.

- *PPP për strehimin social dhe përmirësimin e lagjeve në qytetin e Korçës, nëpërmjet menaxhimit të pronave vendore dhe për të ofruar strehim dhe shërbimet përkatëse për komunitetin në nevojë.*

Korca ofron një trashëgimi të pasur kulturore në arkitekturë, urbanistikë, monumente kulture, kulinari.

- *PPP në ruajtjen dhe promovimin e pasurive kulturore dhe historike dhe në promovimin e traditave shqiptare.*
- *Pazari i Korçës, një element autentik dhe kulturor dhe kthimin e tij në një destinacion turistik me ndihmë të PPP.*

Ekoturizmi është një nga sektorët në rritje të vazhdueshme në zonën e Korçës. Ndonëse ngritur fillimisht mbi baza familjare numri i turistëve dhe interesit të tyre për zonën vijon të jetë në rritje duke sjell domosdoshmeri:

- Përmirësimin e infrastrukturës ndërlidhëse, ofrimit të transportit publik.
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sidomos në zonat e thella që izoloohen nga dimri.
- PPP në përmirësimin e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve.
- *Në zonat e thella këshillohen PPP në krijimin e një entiteti të vetëm që grupon disa komuna për të ulur kështu dhe kostot e shërbimit.*

Këto janë zonat që vuajnë më tepër pasojat e migrimit.

- *PPP në formimin dhe trajnimin e Guidave Profesionale.*

Të ngritura kryesisht si biznese familjare kanë vështiresi në ofrimin e guidave personale që do të nxisnin dhe forma të reja turizmi malor dhe sporteve malore.

Në park gjenden shume burime natyrore si burimet e Shën Gjergjit, Pllakës, Pllicës etj.

Është për tu shënuar fakti se në park gjendet në shumicë druri i pishës së zezë, panja dhe tisi (Taxus bacata) që është tepër i rrallë.

- *PPP në rehabilitimin dhe rigjenerimin e pyjeve dhe parqeve.*
- *PPP në sigurimin e parqeve dhe pyjeve për ndalimin e gjuetisë si problem i identifikuar tashmë prej kohësh.*
- *PPP në krijimin e tregjeve për të promovuar produktet tradicionale të zonës*
- *PPP në fushën e Mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve dhe kullotave, në rehabilitimin e zonave pyjore, mbrojtja dhe zhvillimi i Parkut kombëtar “Bredhi i Drenovës”.*
- *PPP në mbrojtjen dhe zhvillimin e Florës dhe faunës së parkut kombëtar dhe pyllit të fazanëve, monument kulture që prej viteve 60.*

Zona funksionale Fier

Zona funksionale Fier përbëhet nga 11 njësi administrative territoriale. Qendra urbane e këtij rajoni është qyteti i Fierit. Kjo zonë funksionale përfshin komunat Cakran, Dermenas, Frakull, Libofshë, Mbrostar, Portëz, Qendër, Topojë, Zharrëz, dhe bashkinë Levan.

Sektori mbizotërues në ekonominë e rajonit të Fierit është bujqësia, e cila prodhon rreth 37% të vlerës së shtuar për të gjithë rajonin. Ndonëse të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore nuk janë të disponueshme, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë Fier pjesa dërrmuese e njësive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor. Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Fier ka gjithsej 4242 biznese nga të cilët 71% janë të vendosur në qytetin e Fierit. Mesatarisht 47% e të punësuarve në zonë me përjashtim të qytetit të Fierit veprojnë në sektorin e bujqësisë, ndërkohë që 11% punojnë në ndërtim dhe 10% në industri. Punësimi në qytetin e Fierit mbizotërohet nga shërbimet (42%) i ndjekur nga industria (23%) dhe shërbimet (22%). Meqënëse bujqësia është sektori dominant në këtë zonë funksionale, PPP mund të vijë në ndihmë në sektorë:

- *PPP në vaditje dhe sistemin e kullimit*

Vaditja dhe kullimi janë aplikimi artificial i ujit në tokë dhe heqja artificiale e ujit të tepërt nga toka, respektivisht. Disa toka kërkojnë vaditje apo kullim para se të jenë të gatshme për përdorim për ndonjë prodhim bujqësor; fitime të tjera të tokës nga të dyja praktikat për të rritur prodhimin. Përmirësimet e vaditjes dhe të kullimit nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive. Shpesh të dyja mund të kërkojnë së bashku për të siguruar qëndrueshërinë, prodhimin bujqësor të nivelit të lartë .

Vaditja është shfrytëzuar gjerësisht, vaditësit lokalë në përgjithësi kanë një nivel minimal të kuptuarit se si të veprojnë dhe të ruajnë sistemin. Përveç kësaj, sistemet sipërfaqësore janë shpesh më të pranueshme për bujqërit të cilët i vlerësojnë efektet e mungesës së ujit në bujqësi duke thënë se është më i lehtë aplikimi i sistemit sipërfaqësor.

- *PPP në oganizimin dhe funksionimin e Tregjeve Bujqësore*
- *PPP në rehabilitimin e ish kënetave që rrezikohen nga permytjet*

Fieri përfshin dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës. Si një zonë industriale e rëndësishme Fieri vuan nga ndotja mjedisore e trashëguar dhe nga ndotja që shkaktohet nga industria e naftës dhe rafineritë e vajit ushqimor. Kështu që ndihet nevoja e ndihmës së PPP për rehabilitimin e territorit.

- *PPP në Rehabilitimin e territorit të dëmtuar nga industria si dhe pastrimi i ujërave.*
- *PPP në Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit, nëpërmjet analizimit të burimeve natyrore, ajrit, ujit (Seman), tokës.*
- *PPP në oganizimin dhe funksionimin e Tregjeve Industriale.*
- *Ujësjiellësi dhe kanalizimet*

Një ndër problematikat e tjera është dhe furnizimi me ujë të pijshëm dhe kontrolli i cilësisë së tij.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Qeveria Shqiptare sheh me përparësi tërheqjen e investitorëve të huaj në sektorin e ujit dhe për këtë qëllim parashikon bashkimin e kompanive të ujësjiellesit dhe krijimin e disa rajoneve si një mënyrë për të thithur fondet e investitorëve. Argumenti kryesor për rajonizimin është arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja më pas e investitorëve të huaj në formën e partneritetit publik-privat.

- *Menaxhimi i mbetjeve*

PPP në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane, largimit dhe asgjësimit të mbetjeve, mirëmbajtjen e higjenes publike në qytet, mirëmbajtjen e fushëgrumbullimeve dhe ripozicionimin e fushëgrumbullimeve të pa aprovuara në territorin e bashkisë, fushate për edukimin dhe ndergjegjesimin e qytetarëve.

Shqipëria ka një numër të madh të zonave të mbrojtura, disa prej tyre mund të gjenden në Fier. Deri më tani këto zona në bazë të fragmentimit në shumë NjQV lokale, nuk eeshtë arritur menaxhimi i potencialit të tyre natyror. Në kushtet e riorganizimit, zonat më të mbrojtura do të menaxhohen nga një ose maksimumi dy njësi vendore, të cilat do të kenë mundësi dhe një shans më të mirë mbi potencialin e këtyre zonave. E njëjta pyetje vlen edhe për çështjet e planifikimit

të territorit, menaxhimit të tokës ose kontrollin e territorit. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet gjithashtu duket të kenë shanse për të punuar më mirë dhe në mënyrë më efikase.

- *Rehabilitimi i parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.*
- *Mbrojtja e parkut arkeologjik të Apollonisë, objekteve të tjera të trashëgimisë kulturore.*
- *PPP në promovimin e turizmit kulturor dhe arkeologjik.*
- *PPP në fushën e Mbrojtjes, zhvillimit dhe rehabilitimit e pyjeve dhe kullotave.*
- *PPP në promovimin dhe zhvillimin e agroturizmit*

Largësia në kohë udhëtimi me qendrën e bashkisë është një tregues vendimtar për të siguruar mundësinë e ndërveprimit të qytetarëve me qeverisjen. Në përgjithësi është e dëshirueshme që qendra e njësisë së re të arrihet brenda 1 ore nga njësitë e suprimuara. Qendra e Fierit është e arritshme nga qytetarët në më pak se 20 minuta. Vetëm Libofsha dhe Cakrani janë të vendosur në distancë rreth 25 minuta nga qendra e Fierit dhe me infrastrukturë më pak të mirë për të arritur. Ka disa mënyra për të adresuar këtë problem. Një prej tyre lidhet me nevojën që do të kenë banorët për të arritur në qendrën e ZF-së në të përditshmen e tyre. Në kushtet kur pranë banorëve ekzistojnë shërbimet bazë për të cilat ata kanë nevojë të shkojnë më shpesh, udhëtimi drejt qendrës do të shmanget. Një tjetër mënyrë do të ishte rritja e investimeve dhe përqendrimi i prioritetëve në investime në infrastrukturën fizike dhe transportin që lehtëson këtë akses.

- *Infrastruktura rrugore*

Rrugët e brendshme të qytetit janë pjesërisht të amortizuara . Rrugët lidhëse me shumë fshatra janë në gjendje të keqe. Krijimi i një shërbimi për transportin publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës komunitare brenda njësisë së re administrative, si dhe marrjen e shërbimeve më lehtë të aksesueshme.

- *PPP në mirëmbajtjen e infrastrukturës .*

Fieri është shumë i prekur nga përmytjet e shpeshta, Kështu që nevojitet shtim i investimeve në infrastrukturën mbrojtëse nëpër komunat përgjatë lumit Vjosë edhe mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese, pastrimi i shtrateve të lumenjve, etj.

- *Shërbimi publik (urbanët)*

Përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike duhet të jetë pjesë e një investimi të integruar të sektorit publik dhe të kuadrit të prokurimit.

- *Ndriçimi i rrugëve dhe parkimi publik në qytet me ndihmën e partneritetit publik-privat.*
- *PPP në përmirësimin e cilesisë së rendit publik dhe sigurisë civile, kontrollit të trafikut.*
- *PPP në infrastrukturën dhe shërbimet publike.*

Një kategori e rëndësishme e shërbimeve të ofruara në nivel lokal dhe pjesën qendrore është arsimiti. Sot NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore. Ajo që tërheq vëmendjen në këtë analizë është cilësia e dobët e infrastrukturës arsimore të lidhura drejtpërdrejt me gjenerimin e të ardhurave më të ulëta nga NJQV. Riorganizimi në NJQV më të madhe, e propozuar nga zona funksionale do të çojë në efikasitetin dhe shpërndarjen më të mirë të fondeve në dispozicion.

- *Ndërtimi i shkollave me infrastrukturë dhe objekte të të njëjtave standarte.*

Infrastruktura e nevojshme do të ofrohet në shkolla të tilla jo vetëm për të përbushur nevojat e mësimdhënies, por edhe për aktivitete sportive dhe bashkë-kurrikulare. Do të ketë objekte të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Objektet si shesh lojërash, kopshte, auditor, etj do të ofrohen në këto shkolla. Dhe gjithashtu do të ndërtohet një bibliotekë e mirë me libra dhe revista për nxënësit dhe mësuesit.

Këto shkolla do të kenë infrastrukturë të përshtatshme, qasje në Internet dhe mësimi i kompjuterit me orar të plotë.

Shkollat do të kenë lehtësira për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe duhet të ketë mësues të veçantë. Ngrohja do të jetë e aktivizuar në këto institucione arsimore me energji të ripërtëritshme.

- *Në kushtet ekonomike që jemi, një mundësi, në mos e vetmja, për përmirësimin e gjendjes në spitalet publike është Partneriteti Publik-Privat.*

Ky partneritet nuk është i ri. Në vendet e zhvilluara, dekadat e fundit aplikohet me sukses edhe në sistemin shëndetësor. Është një mënyrë për rritjen e ndikimit të mekanizmave të tregut, duke ruajtur kontrollin publik. Nëpërmjet tij sigurohet si *rol i rregullues* i shtetit (solidariteti social)

ashtu edhe përfitimet e mekanizmave të *tregut*, hapja e *sistemit shëndetësor publik* ndaj konkurrencës, etj.

Të dy partnerët (publik dhe privat) zhvillojnë produktet dhe ndajnë riskun, koston dhe të ardhurat.

Në spitale publike, *partneriteti publik-privat* mund të aplikohet pak a shumë, në të gjitha shërbimet që më parë i ofronte shteti, i cili mund të kontraktojë sektorin privat për të siguruar *shërbime*: pastrim, hoteleri, kuzhinë; *mallra*: medikamente, reagentë kimikë, ushqime, etj; *menaxhim*: të spitalit apo të faciliteteve.

Rajoni i Fierit dhe Vlorës kanë një numër të konsiderueshëm të komuniteteve romë dhe egjyptianë që kanë nevojë për shërbime specifike, të cilat mungojnë ose janë të ofruara në bazë të projekteve. Të gjitha këto aspekte janë shtuar për rëndësinë e një menaxhimi më të mirë të territorit, në aspektin e njohurive të nevojave të komunitetit dhe ofrimin efikas të shërbimeve. Argumenti kryesor është se bashkitë nuk kanë as kapacitet financiar as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë dukshëm në ofrimin e shërbimit të barabartë, duke i dhënë përparësi mbulimit rural. E gjithë kjo mund të bëhet e mundur edhe me ndihmën e PPP.

Zona funksionale Vlorë

Zona funksionale Vlorë përbëhet nga 11 njësi: bashkitë Vlorë, Selenicë, Orikum dhe komunat Armen, Brataj, Kotë, Novoselë, Qendër, Selenicë, Sevaster, Vllahinë.

Zona funksionale Vlorë ka 5.678 biznese gjithsej, nga të cilat 78% janë të vendosur në qytetin e Vlorës. Mbi 60% e të punësuarve në zonat urbane të Vlorës veprojnë në sektorin e shërbimeve, ndërkohë që në zonat rurale mbizotëron bujqësia. Vlora ka një përqindje papunësie rreth 19%, sipas të dhënave administrative për të papunët e regjistruar.

Shumica e njësive në zonën funksionale kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kjo është një zonë kryesisht bujqësore, me përjashtim të bashkisë Vlorë dhe Orikum, të cilat kanë shërbime të orientuara kryesisht drejt industrisë dhe shërbimeve.

Në zonën e Vlorës kemi një shpërndarje të njëtrajtshme të treguesve të arsimit dhe shifrat nuk tregojnë dallime të mëdha midis numrit të fëmijëve dhe nxënësve për edukatorë dhe mësues. Numri i fëmijëve luhatet nga 15 – 22, ndërsa ai i nxënësve luhatet nga 10-17 për shkollat 9-vjeçare dhe 10-14 për shkolla e mesme.

Në Vlorë ka 2 spitale dhe ka një shpërndarje të mirë të mjekëve për familje (MPF) dhe mjekë specialistë.

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, në qarkun Vlorë vërehet trend i përgjithshëm i përqendrimit të shërbimeve në qendrat e mëdha urbane, pjesa më e madhe e të cilave gjenden në Vlorë dhe vetëm dy qendra në Sarandë; Ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin. 596 Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë ofruesit jopublikë, NGO-të (OJQ-të), ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesorë të tyre. Ka pasur përpjekje për financime të qendrave ditore për moshën e tretë nga disa bashki si Tirana, Kukësi Shkodra, Vlora dhe Korça, por këto janë shumë të pamjaftueshme. Ndërkohë që vihet re që për periudhën 2009-2011, ka pasur një fluks të kthimit të emigrantëve kryesisht në Tiranë, Fier e Vlorë. Të dhënat sociale nxjerrin në pah dhe një problematikë të re sociale që ka të bëjë me ri-integrimin e tyre në vend sipas specifikave të grup-

moshës. Fenomeni i rikthimit shton presionin dhe ndaj zyrave të punës në të cilat vetëm në vitin 2013, u regjistruan si të papunë mbi 2,000 emigrantë punëkërkuar të kthyer nga emigracioni, ndërkohë që arsimimi dhe njohja e kualifikimeve të fituara jashtë vendit janë gjithashtu aspekte emergjente.

Koha mesatare e udhëtimit drejt qendrës së zonës funksionale, bashkisë Vlorë, është 35 minuta. Qendra e kësaj zone, arrihet në më pak se një orë nga secila njësi, çka lehtëson mjaft ndërveprimin e qytetarëve me institucionet e qeverisjes vendore dhe aksesin në shërbime. Infrastruktura e transportit në Vlorë është e mirë në pjesën më të madhe të zonës funksionale, me përjashtim të aksesit për disa komuna (veçanërisht Brataj, Shushicë dhe Sevaster). Bashkimi në një zonë funksionale do të kërkojë edhe vëmendje të shtuar për akordimin e fondeve për të përmirësuar qasjen e këtyre banorëve drejt qendrës. Gjithsesi, pavarësisht bashkimit në një administratë unike për zonën funksionale, do të ruhen sportelet dhe zyrat e shërbimit bazë për qytetarët në komunat ekzistuese në mënyrë që të sigurohet shërbimi normal për nevojat e komuniteteve vendase.

Vlora është një qendër e rëndësishme tregtare në Shqipëri. Industria e peshkimit është shumë e zhvilluar. Vlora prodhon naftë, gaz natyror, bitum dhe kripë. Industria tekstile dhe industria e ndërtimit është mjaft e zhvilluar në qytet. Vitet e fundit ka patur një zhvillim të madh të turizmit, lidhur me ndërtimin e hoteleve të shumta, restorante, plazhe.

Porti i Vlorës është porti i dytë i Shqipërisë pas Portit të Durrësit në aspektin e madhësisë dhe kapacitetit. Ai është porti më i madh i jugut dhe i shërben të gjithë qendrave jugore të Shqipërisë dhe ngarkesave tranzit në thellësi të Ballkanit, Kosovës, Maqedonisë, etj.

Porti i Vlorës është një port i hapur me dy gjire për anijet tregtare dhe tragetet. Kjo është një pjesë integrale e korridorit 8 për transportin e mallrave të ndryshme.

Duke pasur parasysh nevojën gjithnjë në rritje për një port me infrastrukturë moderne, PPP-të mund të vijnë në ndihmë për realizimin e këtij projekti.

Meqënëse ka një zgjerim të bregdetit në këtë rajon PPP mund të merret me:

- *Menaxhimi i unifikuar i bregdetit*
- *Menaxhimi i plazheve publike*
- *Mirëmbajtja e plazheve*
- *Mbrojtja*

Për sa i përket sektorëve të tjerë ku PPP mund të vijnë në ndihmë janë:

Vlora është përfshirë nga një bum i madh ndërtimi që ka sjell probleme të mëdha në menaxhimin e mbetjeve urbane dhe të ngurta.

- *Infrastruktura rrugore*

PPP në ndërtimin e infrastrukturës rrugore vecanërisht përgjatë bregdetit, e cila është dhe zona më e prekur nga ndërtimet pa leje ku mund të përmendim zonën e Vlorës dhe Orikutit.

- *Shërbimi publik (urbanët)*

Përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike duhet të jetë pjesë e një investimi të integruar të sektorit publik dhe të kuadrit të prokurimit.

Krijimi i një shërbimi të transportit publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës së komunitetit brenda njësisë së re administrative, si dhe duke bërë shërbimet më lehtë të arritshme.

- *Ndriçimi i rrugëve dhe parkimi publik në qytet me ndihmën e partneritetit publik-privat.*
- *PPP në përmirësimin e cilesisë së rendit publik dhe sigurisë civile, kontrollit të trafikut.*
- *PPP në infrastrukturën dhe shërbimet publike.*
- *PPP në zhvillimin e industrisë së peshkimit.*
- *Përmirësimi i kanalizimeve ku ndërtimet janë me gropa septike, sidomos përreth Ujit të Ftohtë.*
- *PPP në ndërtimin, përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e zonës ekonomike me statusin e “Parkut Industrial” në Vlorë, miratuar më 4 qershor 2008. Në këtë sipërfaqe 125 hektarë, investimi duhet ishte në shumën 21 milionë euro dhe do të krijoheshin 18.586 vende pune.*
- *Rehabilitimi i parkut detar bregdetar të Sazan Karaburun.*
- *Ujesjellësi dhe kanalizimet*

PPP në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve. Ndërtimet e shumta sidomos në Vlorë, Orikum dhe Radhimë kanë krijuar mbingarkesë mbi shërbimet publike bazë.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Qeveria Shqiptare sheh me përparësi tërheqjen e investitorëve të huaj në sektorin e ujit dhe për këtë qëllim parashikon bashkimin e kompanive të ujësjellesit dhe krijimin e disa rajoneve si një mënyrë për të thithur fondet e investitorëve. Argumenti kryesor për rajonizimin është arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja më pas e investitorëve të huaj në formën e partneritetit publik-privat.

- *Menaxhimi i mbetjeve*

PPP në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane, largimit dhe asgjësimit të mbetjeve, mirëmbajtjen e higjenes publike në qytet, mirëmbajtjen e fushëgrumbullimeve dhe ripozicionimin e fushëgrumbullimeve të pa aprovuara në territorin e bashkisë, fushate për edukimin dhe ndergjegjesimin e qytetarëve.

- *PPP në vaditje dhe sistemin e kullimit*

Vaditja dhe kullimi janë aplikimi artificial i ujit në tokë dhe heqja artificiale e ujit të tepërt nga toka, respektivisht. Disa toka kërkojnë vaditje apo kullim para se të jenë të gatshme për përdorim për ndonjë prodhim bujqësor; fitime të tjera të tokës nga të dyja praktikat për të rritur prodhimin. Përmirësimet e vaditjes dhe të kullimit nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive. Shpesh të dyja mund të kërkojnë së bashku për të siguruar qëndrueshërinë, prodhimin bujqësor të nivelit të lartë .

Vaditja është shfrytëzuar gjerësisht, vaditësit lokalë në përgjithësi kanë një nivel minimal të kuptuarit se si të veprojnë dhe të ruajnë sistemin. Përveç kësaj, sistemet sipërfaqësore janë shpesh më të pranueshme për bujqërit të cilët i vlerësojnë efektet e mungesës së ujit në bujqësi duke thënë se është më i lehtë aplikimi i sistemit sipërfaqësor.

- *PPP në Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit, nëpërmjet analizimit të bregdetit.*
- *PPP në organizimin dhe funksionimin e Tregjeve Bujqësore dhe Industriale.*
- *Ndërtimi i shkollave me infrastrukturë dhe objekte të të njëjtave standarte.*

Infrastruktura e nevojshme do të ofrohet në shkolla të tilla jo vetëm për të përmbushur nevojat e mësimdhënies, por edhe për aktivitete sportive dhe bashkë-kurrikulare. Do të ketë objekte të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Objektet si shesh lojërash, kopshte, auditor, etj do të ofrohen në këto shkolla. Dhe gjithashtu do të ndërtohet një bibliotekë e mirë me libra dhe revista për nxënësit dhe mësuesit.

Këto shkolla do të kenë infrastrukturë të përshtatshme, qasje në Internet dhe mësimi i kompjuterit me orar të plotë.

Shkollat do të kenë lehtësira për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe duhet të ketë mësues të veçantë. Ngrohja do të jetë e aktivizuar në këto institucione arsimore me energji të ripërtëritshme.

- *Në kushtet ekonomike që jemi, një mundësi, në mos e vetmja, për përmirësimin e gjendjes në spitalet publike është Partneriteti Publik-Privat.*

Ky partneritet nuk është i ri. Në vendet e zhvilluara, dekadat e fundit aplikohet me sukses edhe në sistemin shëndetësor. Është një mënyrë për rritjen e ndikimit të mekanizmave të tregut, duke ruajtur kontrollin publik. Nëpërmjet tij sigurohet si *rol i rregullues* i shtetit (solidariteti social) ashtu edhe përfitimet e mekanizmave të tregut, hapja e *sistemit shëndetësor publik* ndaj konkurrencës, etj.

Të dy partnerët (publik dhe privat) zhvillojnë produktet dhe ndajnë riskun, koston dhe të ardhurat.

Në spitale publike, *partneriteti publik-privat* mund të aplikohet pak a shumë, në të gjitha shërbimet që më parë i ofronte shteti, i cili mund të kontraktojë sektorin privat për të siguruar *shërbime*: pastrim, hoteleri, kuzhinë; *mallra*: medikamente, reagentë kimikë, ushqime, etj; *menaxhim*: të spitalit apo të faciliteteve.

- *PPP në fushën e Mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve dhe kullotave, në rehabilitimin e zonave pyjore, mbrojtja dhe zhvillimi i Parkut kombëtar "LLOGARA"*
- *PPP në administrimin e parkut kombëtar.*
- *Turizmi Bregdetar dhe Malor, përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës.*

- *Zgjerimi i industrisë së veshjeve* që luan një rol të rëndësishëm në këtë fushë, sepse Vlora ka një pozitë të mirë strategjike duke pasur afër portin që mundëson eksportin e mallrave në vendet e zhvilluara. Kjo shkakton një rritje në punësim.

Zona funksionale Përmet

Zona funksionale Përmet përfshin 9 njësi eksistuese të qeverisë lokale: bashkia Përmet , Këlcyrë dhe komunat Ballaban, Çarshovë, Deshnicë, Frashër, Petran, Qendër Piskovë, Sukë.

Spektori dominues në ekonominë e rajonit të Përmetit është bujqësia, e cila punëson rreth 50% të të punësuarve të njësisë, me përjashtim të Përmetit. Ndonëse nuk disponohen të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore , konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë së Përmetit, pjesa më e madhe e njësisë të reja të përfshira kanë karakter bujqësor. Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Gjirokastrë ka 576 biznese gjithsej, mbi 60% e të cilave janë vendosur në qytetin e Përmetit.

Një tjetër kategori e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimiti. Sot NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën në vijim prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia e këtyre strukturave. Ajo që vëhet re, pothuaj në secilin qark të ZF-së së propozuar, është se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave nga NJQV-të (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në një NJQV më të madhe, sipas zonës funksionale të propozuar, do të rezultonte në efikasitet dhe shpërndarje më të mirë të fondeve në dispozicion.

Përmeti ka një spital, ndërsa shpërndarja e qendrave shëndetësore është si më poshtë:

Për sa u përket shërbimeve sociale, në zonën funksionale Përmet nuk ndodhet asnjë qendër shërbimi. Mbulimi me shërbime sociale është një sfidë për të gjithë territorin e vendit e janë duke u artikuluar masat përkatëse në bashkëpunim me shërbimet e tjera sociale, siç janë dhe Zyrtat Rajonale të Punësimit. Ndarja në zona më të vogla do të ndihmojë në rritjen e funksionalitetit brenda zonave të reja, të cilat do të funksionojnë si satelitë rreth njësisë/ve kryesore historike ku përqendrohen edhe shërbimet. Masat që po ndërmerren në drejtim të shërbimeve të ndryshme

sociale përfshijnë mbulimin e tërë territorit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zonave rurale në të cilat këto shërbime nuk ekzistojnë. Shkrimja e njësisve vendore ofron mundësi për menaxhim më të mirë jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të atyre ato njerëzore në drejtim të ofrimit të shërbimeve. Duke lehtësuar e rikompozuar sistemin e menaxhimit, do të mund të lehtësohen strukturat aktuale në zonat rurale, për t'u përqendruar më shumë në ofrimin e shërbimeve dhe vlerësimin e nevojave të komunitetit.

Për sa i përket furnizimit me ujë dhe aksesit në shërbimin e kanalizimeve, situata në Përmet rezulton të jetë disi problematike. Përveç Përmetit dhe Këlcyrës, zonat e tjera janë mbrapa për sa u përket këtyre treguesve dhe ka komuna, të tilla si Frashëri, ku familjet kanë vetëm 10% akses në furnizim me ujë dhe vetëm 5% e tyre ka akses në rrjetin e kanalizimeve. Po ashtu, edhe numri i makinave është i ulët, me përqindjen maksimale prej rreth 23% në Përmet. Situata është dramatike për sa i përket aksesit në telefoninë fikse dhe internet, ku mbulimi për këtë të fundit është minimal (13%) në Përmet, shumë i pakët në Këlcyrë (6%) dhe Petran (5%) dhe i papranishëm në zona të tjera. Shërbimi i telefonisë celulare është disi më i mirë dhe shifrat variojnë nga 24 – 28%.

PPP në këtë zonë funksionale mund të vijë në ndihmë në këto sektorë:

- *Infrastruktura rrugore*

Rrugët e brendshme të qytetit janë pjesërisht të amortizuara . Rrugët lidhëse me shumë fshatra janë në gjendje të keqe. Krijimi i një shërbimi për transportin publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës komunitare brenda njësisë së re administrative, si dhe marrjen e shërbimeve më lehtë të aksesueshme.

- *PPP në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës si mjet për rritjen e cilësisë së shërbimit.*
- *PPP në përmirësimin e cilësisë së rendit publik dhe sigurisë civile, kontrollit të trafikut.*
- *Shërbimi publik (urbanët)*

Përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike duhet të jetë pjesë e një investimi të integruar të sektorit publik dhe të kuadrit të prokurimit.

Krijimi i një shërbimi të transportit publik në shërbim të fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës së komunitetit brenda njësisë së re administrative, si dhe duke bërë shërbimet më lehtë të arritshme.

- *Ndriçimi i rrugëve dhe parkimi publik në qytet me ndihmën e partneritetit publik-privat.*

Një pjesë e madhe e këtij rajoni janë përcaktuar si zona bujqësore. PPP do të jetë një alternativë e mirë për të përmirësuar dhe për të zhvilluar ekonominë e këtij rajoni.

- *PPP në vaditje dhe sistemin e kullimit*

Vaditja dhe kullimi janë aplikimi artificial i ujit në tokë dhe heqja artificiale e ujit të tepërt nga toka, respektivisht. Disa toka kërkojnë vaditje apo kullim para se të jenë të gatshme për përdorim për ndonjë prodhim bujqësor; fitime të tjera të tokës nga të dyja praktikat për të rritur prodhimin. Përmirësimet e vaditjes dhe të kullimit nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht ekskluzive. Shpesh të dyja mund të kërkohen së bashku për të siguruar qëndrueshërinë, prodhimin bujqësor të nivelit të lartë .

Vaditja është shfrytëzuar gjerësisht, vaditësit lokalë në përgjithësi kanë një nivel minimal të kuptuarit se si të veprojnë dhe të ruajnë sistemin. Përveç kësaj, sistemet sipërfaqësore janë shpesh më të pranueshme për bujqërit të cilët i vlerësojnë efektet e mungesës së ujit në bujqësi duke thënë se është më i lehtë aplikimi i sistemit sipërfaqësor.

- *PPP në Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit, nëpërmjet analizimit të bregdetit.*
- *PPP në organizimin dhe funksionimin e Tregjeve Bujqësore dhe Industriale.*
- *Ujësjellësi dhe kanalizimet*

PPP në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve. Ndërtimet e shumta sidomos në Vlorë, Orikum dhe Radhimë kanë krijuar mbingarkesë mbi shërbimet publike bazë.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Qeveria Shqiptare shihet me përparësi tërheqjen e investitorëve të huaj në sektorin e ujit dhe për këtë qëllim parashikon bashkimin e kompanive të ujësjellesit dhe

krijimin e disa rajoneve si një mënyrë për të thithur fondet e investitorëve. Argumenti kryesor për rajonizimin është arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja më pas e investitorëve të huaj në formën e partneritetit publik-privat.

- *Menaxhimi i mbetjeve*

PPP në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane, largimit dhe asgjësimit të mbetjeve, mirëmbajtjen e higjenes publike në qytet, mirëmbajtjen e fushëgrumbullimeve dhe ripozicionimin e fushëgrumbullimeve të pa aprovuara në territorin e bashkisë, fushate për edukimin dhe ndergjegjesimin e qytetarëve.

- *Ndërtimi i shkollave me infrastrukturë dhe objekte të të njëjtave standarte.*

Infrastruktura e nevojshme do të ofrohet në shkolla të tilla jo vetëm për të përmbushur nevojat e mësimdhënies, por edhe për aktivitete sportive dhe bashkë-kurrikulare. Do të ketë objekte të mjaftueshme për sport, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Objektet si shesh lojërash, kopshte, auditor, etj do të ofrohen në këto shkolla. Dhe gjithashtu do të ndërtohet një bibliotekë e mirë me libra dhe revista për nxënësit dhe mësuesit.

Këto shkolla do të kenë infrastrukturë të përshtatshme, qasje në Internet dhe mësimi i kompjuterit me orar të plotë.

Shkollat do të kenë lehtësira për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe duhet të ketë mësues të veçantë. Ngrohja do të jetë e aktivizuar në këto institucione arsimore me energji të ripërtëritshme.

- *Në kushtet ekonomike që jemi, një mundësi, në mos e vetmja, për përmirësimin e gjendjes në spitalet publike është Partneriteti Publik-Privat.*

Ky partneritet nuk është i ri. Në vendet e zhvilluara, dekadat e fundit aplikohet me sukses edhe në sistemin shëndetësor. Është një mënyrë për rritjen e ndikimit të mekanizmave të tregut, duke ruajtur kontrollin publik. Nëpërmjet tij sigurohet si *rol i rregullues* i shtetit (solidariteti social) ashtu edhe përfitimet e mekanizmave të tregut, hapja e sistemit shëndetësor publik ndaj konkurrencës, etj.

Të dy partnerët (publik dhe privat) zhvillojnë produktet dhe ndajnë riskun, koston dhe të ardhurat.

Në spitale publike, *partneriteti publik-privat* mund të aplikohet pak a shumë, në të gjitha shërbimet që më parë i ofronte shteti, i cili mund të kontraktojë sektorin privat për të siguruar *shërbime*: pastrim, hoteleri, kuzhinë; *mallra*: medikamente, reagentë kimikë, ushqime, etj; *menaxhim*: të spitalit apo të faciliteteve.

- *PPP për mbulimin e kësaj zone funksionale me telefoni fikse dhe internet.*

Përmeti ofron një trashëgimi të pasur kulturore në monumente kulture, monumente fetare, Kisha e Shën Mërisë në Leusë të Përmetit.

- *PPP në administrimin e kaskadës*
- *PPP në ruajtjen dhe promovimin e pasurive kulturore dhe historike dhe në promovimin e traditave shqiptare.*
- *PPP në fushën e Mbrojtjes, zhvillimit dhe rehabilitimin e pyjeve dhe kullotave.*

Përmeti është i njohur për turizmin kulinar. PPP mund të ndihmojë në këtë sektor, për zhvillimin e këtij turizmi. Edhe në zhvillimin e industrisë në prodhimet vendore dhe eksportin e tyre në Evropë.

Përmeti gjithashtu njihet për banjot termale. Banjot termale të Benjes janë nga burimet e vendit të cilat dalin nga ujera sulfurore subtermale. Ndodhet rreth 8 kilometra larg nga qendra e Përmetit. Që në hyrje të zonës dallohet qarte Ura e Katiut, e ndërtuar që në kohët e hershme që qendron dhe sot pa asnjë problem. Aty fillojnë grupe burimesh, nga të cilat janë formuar me pas liqene të vogla me uje të madhesive të ndryshme. Secili liqen shërben për kurimin e një problemi specifik, si përshembull aknet dhe semundje të tjera të lekures, reumatizma dhe semundje të kockave, stomaku etj. Një nga aspektet më të vecanta është egzistenca e një pellgu me balte shëruese, për të cilën të moshuarit shprehen se është një çelës për ta pasur lekuren gjithmone të fresket e të re.

- *PPP në administrimin e lixhave “Llixhat dhe banjat termale të Bënjës”*

- *PPP në zhvillimin e sektorit të agrobiznesit nëpërmjet rilindjes së traditës së prodhimit të produkteve origjinale të zonës si prodhimit të verës, të glikosë etj.*
- *PPP në zhvillimin e turizmit. Prej disa kohesh sektori i turizmit ka filluar të zhvillohet në këtë zonë ndonëse familjar.*
- *Trajnimi dhe përgatitja e guidave profesionale.*
- *Ndalimi i gjuetisë së paligjshme.*

Përfitimet e Partneritetit Publiko-Privat

Disa nga arsytet për adoptimin e qasjes së PPP:

- Rrit cilësinë e garantuar të shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve (ndriçimit publik, ngrohje dhe institucionet arsimore publike).
- Lehtëson ndjeshëm buxhetin, duke bërë që paratë e tatimpaguesve të shkojnë direkt në investime për ta. Duke u ndalur në pikën e dytë për të qenë transparent për qytetarin sqarojmë se për sa i përket shpenzimeve publike të energjisë elektrike, qyteti shpenzon një vlerë të konsiderueshme monetare. Ndriçimi publik zë 90% të totalit të zërit të shpenzimeve publike. Kjo vlerë të hollash nuk mund të tejkalohet vetëm me tarifë shërbimi që paguajnë qytetarët. Gjithashtu në një kohë kur kërkesa për mjedise të rehatshme në institucionet arsimore publike është mjaft e drejtë, pavarësisht kufizimeve buxhetore të zonave funksionale, Partneriteti Publik-Privat do të jetë një përgjigje e mirë e këtyre kërkesave.
- Mundësia e krijimit të një numri më të madh shkollash se çfarë shpenzimi publik mund të përballojë, me anë të kontributit në shpenzimet kapitale nga partnerët privat.
- Efikasiteti funksional i subjekteve private që mundësojnë ofrimin e hershëm të arsimit cilësor.
- Rreziku i përfundimit të projektit dhe shpërndarja e rezultateve të miratuara do të kryhet nga subjekti privat.
- Fondet publike do të shpenzohen vetëm pas dorëzimit të rezultateve të miratuara.
- Efikasiteti i sektorit privat në kuadrin e një marrëveshjeje afatgjatë pritet të përmirësojë cilësinë e arsimit, duke përfshirë infrastrukturën shkollore.